

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 116, datë 28.05.2026

**PËR
LICENCIMIN SI AGJENT NË SIGURIME NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË
SHOQËRISË SË SIGURIMIT “ALBSIG” SH.A., SI DHE MIRATIMIN E AGJENTIT
NË SIGURIME NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË SUBJEKTIT “EMA’S AGENCY”
SH.P.K.**

Në zbatim të nenit 14, pika 4, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të neneve 194 e vijim të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe të rregullores nr. 79, datë 31.08.2015 “Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime, si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij dhe refuzimit të licencës”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Licencimin e subjektit “EMA’S AGENCY” sh.p.k. për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime, në klasat e jojetës, në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit “Albsig” sh.a.**
- 2. Miratimin e znj. Merjemë Zyko për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime, në klasat e jojetës, në emër dhe për llogari të subjektit “EMA’S AGENCY” sh.p.k.**
- 3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Saimir TOLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Adela XHEMALI